



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:006075
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05730642

C.nr.2395/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Durim BALAJ dhe me bashkëpunëtorin profesional Senad Lokaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit M.SH., nga fshati, Komuna e Gjakovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 364.00 euro, jashtë seancës, më 24 maj 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.SH., nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit së lartcekur, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 10.01.2022 e deri me datën 21.11.2022, respektivisht për 182 ditë të pranisë në punë, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 364.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloj të llogaritet nga data 14.12.2023, (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit t’ia paguaj shumën prej 98.00 euro, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë me datë 14.12.2023, përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria e Arsimit, duke theksuar se paditësi është i punësuar në Shkollën “...” në fshatin .., Komuna e

Gjakovës. Andaj, ka kërkuar që të detyrohet e paditura që për periudhën nga data 10.01.2022 e deri me datë 22.11.2022, për 182 ditë pune, paditësit t'ia kompensoj e shumë prej 364.00 euro, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 03.05.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se sipas kontratës së punës askund nuk është cekur se paditësit i takon kompensimi i shpenzimeve të ushqimit në punë, të cilën kontratë e ka nënshkruar paditësi dhe është pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka. Po ashtu, paditësit nuk i takon ky kompensim as me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës e ku askund nuk e parasheh që punëtorëve të arsimit iu takojnë kompensimet e tilla, prandaj kërkesës së paditësit i mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësi nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënëse e vetëm e kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Sipas kontratave të punës parashihet për mësimdhënës që të i kenë 20 orë në javë si orë pune dhe 20 orë në javë si orë mësimi, ndërsa vërtetimet nuk qartësojnë çështjen e konkretizimit sa i përket ditëve të punës, duke theksuar se nuk mund të llogaritet si ditë pune e plotë koha prej katër-pesë orëve punë aktive në shkollë. Kontrata Kolektive parasheh mundësinë e punëtorëve që të kenë edhe ndonjë vend tjetër të punës andaj kompensimi është i lidhur me një punë të përcaktuar e cila llogaritet si punë primare, mbi këtë bazë mungojnë dëshmitë nga Administrata Tatimore që konfirmon faktin që paditësi nuk është i angazhuar edhe në ndonjë punë tjetër. Po ashtu sa i përket shujtave, duhet të ketë domosdoshmërisht dëshmi nga institucioni përkatës se nuk është e rregulluar forma e ushqimit brenda institucionit dhe që nuk paguhet ndonjë shtesë për shujtë nga punëdhënësi. Po ashtu e njëjta është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e themeltë dhe si e tillë në tërësi u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se paditësi është i punësuar si mësimdhënës në Shkollën “..” në fshatin ..., Komuna e Gjakovës, dhe nga data 10.01.2022 e deri me datën 21.11.2022, paditësi ka punuar gjithsej 182 ditë pune, fakt i vërtetuar përmes Vërtetimit mbi ditët e prezencës në punës me numër 913/23 të datës 20.11.2023, të lëshuara nga U.D. drejtori i shkollës së lartcekur. Gjykata provës së lartcekur ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tij, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të datës të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e datës 22.01.2021, e cila ka qenë në fuqi deri me datën 21.11.2022. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditësit nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me nenin 35 par.7 të dhe asaj të datës 22.01.2021, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të te punësuarve për ushqim për ta bërë kompensimin”*, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 10.01.2022 e deri me datën 21.11.2022, respektivisht për 182 ditë të pranisë në punë rezulton shuma prej 364.00 euro.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për shujta, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila në nenin 2 par.1 ka përcaktuar se *“Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm, të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.”* Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës numër 03/L-212 ku ndër të tjera ky ligj në nenin 90 par.5, ka përcaktuar se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe*

punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”. Andaj, për këtë arsye, gjykata konsideron se edhe pse Ligji i Punës specifikisht nuk e ka përcaktuar kompensimin për shujta, një gjë të tillë e ka paraparë Kontrata Kolektive e Arsimit, si marrëveshje kolektive në përputhje me Ligjin e Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Gjykata analizoi edhe pretendimin e të paditurës se nuk mund të llogaritet si ditë pune e plotë koha prej katër - pesë orëve punë aktive në shkollë, mirëpo gjykata ditët e pranisë në punë i ka vërtetuar përmes Vërtetimit të lëshuar nga shkolla përkatëse ku punon paditësi dhe të njëjtës ia fali besimin pasi që është e hartuara në formën e caktuar nga organi përkatës brenda kufijve të kompetencës së tij.

Sa i përket pretendimit të të paditurës se paditësi nuk ka ofruar prova sa i përket faktit nëse është i punësuar edhe në ndonjë punë tjetër, si dhe nuk ka ofruar prova nga institucioni përkatës se a e ka të rregulluar formën e ushqimit brenda institucionit, gjykata vë në dukje se bazuar në nenin 7 par.1 të LPK-së është përcaktuar se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, andaj meqenëse e paditura nuk ka ofruar prova materiale përmes të cilat mbështeten pretendimet e lartcekura, andaj gjykata të njëjta i refuzoi si të pabazuara.

Gjykata analizoi edhe pretendimet e tjera të përfaqësuesit ligjor të të paditurës dhe atë në lidhje me faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative për realizimin e kërkesës, mirëpo një pretendim të tillë e refuzoi pasi që gjykata nuk është e lidhur me mjetet administrative brenda institucionit përkatës kur vendos lidhur me kërkesën. Në rastin konkret, për të paditurën detyrimi për t’iu kompensuar kompensimi në emër të ushqimit rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit dhe nuk duhet të jetë e lidhur me kërkesën e të punësuarit. Rrjedhimisht paditësit, si i punësuar në arsim, nuk ka qenë i detyruar që të bëjë kërkesë të veçantë për kompensim të shujtave, pasi të njëjtën punëdhënësi do të duhej ta përmbushte në momentin që janë plotësuar kushtet për kompensimin e tyre në përputhje me kontratën kolektive të

lartcekur, prandaj meqë një detyrim i tillë nuk është përmbushur, ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin përmes rrugëve gjyqësore, siç ka vepruar në rastin konkret paditësi.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës, mirëpo i njëjti pretendim ishte i pabazuar, ngase paditësi ka kërkuar kompensim për periudhën nga data 10.01.2022-21.11.2022, ndërsa paditësi padinë e ka parashtruar me datën 14.12.2023, pra brenda afatit prej tre (3) viteve, ashtu siç parashihet me nenit 87 të Ligjit të Punës.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, u mor sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç'rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 98.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro, e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 78.00 euro, të paraparë sipas Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur dhe nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2395/23, më 24 maj 2024

Gj y q t a r i
Durim BALAJ

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.